




Banka e Shqipërisë

AFISaR

SISTEMI SHQIPTAR I SHLYERJES DHE REGJISTRIMIT TË TITUJVE



Çfarë është AFISaR-i?

AFISaR është Sistemi i Shlyerjes dhe Regjistrimit të Titujve (bono thesari dhe obligacione) që emetohen nga Shteti Shqiptar, për të cilat Banka e Shqipërisë organizon ankandet e emetimit. Ky sistem siguron mbarëvajtjen e shërbimeve të post-tregimit të titujve.

Sistemi AFISaR ofron:

- lidhje të operatorëve të brendshëm dhe ndërkombëtarë;
 - emetim dhe shpërndarje të shpejtë, eficiente dhe me risk minimal të titujve;
 - fokus në sigurinë e klientëve dhe investitorëve;
 - komunikim përmes portalit me kosto minimale të operatorëve lokalë nëpërmjet WEB station të sigurt, intuitiv dhe mjaft të thjeshtë në përdorim. Nëpërmjet tij, anëtarët mund të kontrollojnë në kohë reale ecurinë e transaksioneve të tyre.
-
- regjistrimin e të dhënave dhe shlyerjen e rezultatit të ankandit të titujve në tregun primar;
 - veprimet me shitblerjen e titujve (DVP);
 - transferimet e portofolit (FOP);
 - regjistrimin, menaxhimin dhe ekzekutimin e marrëveshjeve të riblerjeve (Repo dhe Reverse Repo);
 - menaxhimin e plotë të veprimeve të regjistrimit, çlirimit, ekzekutimit të kolateralit;
 - ndryshimin e kujdestarit të titujve;
 - automatizimin e ngjarjeve si: maturimi total, maturimi i parakohshëm apo rihapja e ankandit;
 - pagesat e interesave dhe kuponave.

2015

Fillon operimi i AFISaR

2018

Pranohet anëtar i parë ndërkombëtar

2018

Realizohet lidhja me Bursën e parë private të titujve

2019

57 mijë transaksione në vit
ALL 587 mld tituj të klientëve
13 banka anëtare
1 bankë qendrore (BSh)
1 emetues (MEFE)

Kush e administron/operon AFISAR-in?

Banka e Shqipërisë është pronar/administrator dhe operator qendror i sistemit AFISaR.

Administratori i sistemit mban dhe menaxhon llogaritë e pjesëmarrësve në sistem dhe merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar ruajtjen e të dhënave për të mbrojtur të drejtat e pjesëmarrësve që burojnë nga pronësia mbi titujt. Administratori siguron vijueshmërinë e funksionimit të sistemit edhe në rrethana të papara-shikuara, duke ndërtuar plane emergjence dhe ambient backup të sistemit.

Sistemi AFISaR është i hapur dhe operativ çdo ditë pune në Republikën e Shqipërisë. Oraret ekzekutohen automatikisht nga sistemi me përjashtim të hapjes dhe mbylljes së tij, të cilat menaxhohen nga Administratori.

Për të siguruar mbarëvajtjen e sistemit dhe të proceseve, Banka e Shqipërisë ka të drejtë të modifikojë orarin, edhe gjatë ditës së punës.

Orari normal i punës



Kush mund të jetë anëtar në AFISaR?



Drugët e komunikimit janë:

- VPN (Rrjet Privat virtual)
- SWIFT

Komunikimi bazohet në klasën MT5XX.

- Banka Qendrore
- Ministria e Financave
- Bankat në Shqipëri
- Shoqëritë komisionere rezidente ose jorezidente
- Institucionet financiare rezidente (të ndryshme nga bankat)
- Institucionet financiare jorezidente
- Depozitarët qendrorë jorezidentë
- Shtëpitë e klerimit të titujve



Si mund të hapet një llogari në AFISaR për depozitimin e titujve?

Kusht absolut për çdo person fizik apo juridik të interesuar për të pasur një llogari titulli në sistemin AFISaR, është zotërimi i një llogarie cash-i. Kjo llogari cash-i mund të hapet drejtpërdrejt në sistemin e shlyerjes së pagesave të Bankës së Shqipërisë – AIPS – ose nëpërmjet njërit prej anëtarëve (bankat tregtare ose Banka e Shqipërisë) të sistemit AIPS.

Llogari e drejtpërdrejtë (anëtar)

- nënshkruhet kontratë me BSH pasi plotësohen një listë me kushte,
- llogaria operohet vetë nga anëtar,
- paguhet tarifë për anëtarësim (një herë), tarifë vjetore dhe tarifë për transaksion.

Llogari e tërthorë nëpërmjet një anëtari (jo BSH) me llogari të veçantë

- nënshkruhet kontratë me anëtarin e AFISaR,
- llogaria operohet nga anëtar,
- paguhet tarifë vjetore dhe tarifë për transaksion të përcaktuara nga BSH, por anëtar që operon llogarinë mund të aplikojë tarifa shtesë.

Llogari e tërthorë nëpërmjet një anëtari (jo BSH) me llogari të veçantë

- nënshkruhet kontratë me anëtarin e AFISaR,
- llogaria operohet nga anëtar,
- paguhet tarifë vjetore dhe tarifë për transaksion të përcaktuara nga BSH, por anëtar që operon llogarinë mund të aplikojë tarifa shtesë.

Llogari e tërthortë nëpërmjet BSH-së me llogari të veçantë

- nënshkruhet kontratë me BSH
- llogaria operohet nga BSH
- tarifë vjetore e përcaktuar nga BSH



KONTAKT

Banka e Shqipërisë, Departamenti i Operacioneve Monetare
Sheshi "Skënderbej", nr. 1, Tiranë; Tel: + 355 4 241 93 01/02/03; Ext: 438, 446-448;
Faks: + 355 4 241 94 08; www.bankofalbania.org; sistemiafisar@bankofalbania.org